



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË KURRIKULËS**

**MIRATOHET  
MINISTRI**

**Luan MEMUSHI**

**PROGRAMI I LËNDËS**

**SË GJUHËS FRËNGE**

**KLASA III**

**CIKLI FILLOR I SHKOLLËS 9-VJEÇARE**

Tiranë, 2005

## **PËRMBAJTJA E PROGRAMIT:**

- I. HYRJE
- II. SYNIMET EDUKATIVE DHE OBJEKTIVAT DIDAKTIKË
- III. PËRSHKRIMI I KATËR AFTËSIVE GJUHËSORE
- IV. STRUKTURA SINTETIKE E PROGRAMIT
- V. STRUKTURA ANALITIKE E PROGRAMIT
  - ❖ TEMATIKA DHE LEKSIKU
  - ❖ AKTET DHE FUNKSIONET E KOMUNIKIMIT
  - ❖ ELEMENTET DHE STRUKTURA GRAMATIKORE
- VI. UDHËZIME DIDAKTIKE
- VII. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT DHE VETËVLERËSIMIT
- VIII. KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTIT

## 1. Hyrje

Në kuadrin e përmirësimit të sistemit shkollor, plani mësimor i gjuhës frënge në klasën e 3-të do të zhvillohet me 2 orë në javë. Sensibilizimi që në moshë të vogël i mësimit të një gjuhe të huaj, ndikon pozitivisht në formimin e përgjithshëm të nxënësit, sepse së bashku me gjuhën e huaj ai merr informacion edhe për kulturën pjesë e së cilës është kjo gjuhë.

Të dish të përdorësh një gjuhë të ndryshme nga gjuha mëmë, është një aftësi jo vetëm gjuhësore, por edhe shoqërore. Mënyrat e të përhëndeturit, të të paraqiturit, të të folurit për veten, janë një trashëgimi socialkulturore në një vend të caktuar.

Integrimi i vëndit tonë në Evropë dhe përgatitja e qytetarit të Evropës së bashkuar, kërkon domosdoshmërisht njohje dhe zotërim të efektshëm të një gjuhe të huaj, e cila mësohet mirë që në moshë të vogël. Ky mësim ka zënë vendin e tij me dinjitet në fushën e mësimdhënies, ka hyrë me te drejta te plota në këtë fushë.

## 2. Synimet edukative dhe objektivat didaktikë

### a. Synime edukative

Të mësosh një gjuhë, është një proces natyror, i cili ndihmon në formimin e përgjithshëm të nxënësit, i jep atij mundësinë për t'u zhvilluar në mënyrë të gjithanshme.

Nëpërmjet mësimit të gjuhës së huaj në moshë të vogël, ne privilegjojmë tek nxënësit aftësitë gjuhësore të të folurit, të dëgjuarit, të kuptuarit dhe më pak ato të të shkruarit. Në të njëjtën kohë, zhvillojmë tek ata aftësitë njohëse, rrisim tek ta aftësitë intelektuale dhe përfshirjen e tyre në shkëmbime të shumëllojshme.

Mësimi nëpërmjet lojërave është me të vërtetë metoda më e pëlqyeshme, nëpërmjet së cilës fëmija njih botën. Metodologjia e lojës i lejon atij të përballojë në mënyrë të natyrshme dhe familjare studimin e gjuhës frënge dhe të përfshijë në procesin e të mësuarit të gjitha aftësitë e tij njohëse, afektive, sociale dhe sensomotorë.

Prandaj këmbëngulet me forcë që mësuesi të arrijë t'i krijojë nxënësit hapësirë që të zbulojë, të veprojë dhe të bashkëveprojë për t'a mësuar këtë gjuhë.

### b. Objektiva didaktikë

#### *Objektivi komunikues:*

Gjuha konsiderohet mjet për t'u shprehur, për të kuptuar, reaguar, imituar, demonstruar njohuri dhe aspekte të përvojës jetësore të përditshme, të popullit gjuhën e të cilit ai mëson. Gjuha mësohet përmes të folurit dhe një i mësuar i tillë nuk kërkon nga fëmija sforcime të mëdha intelektuale; shprehjet dhe fjalët e reja ai i mëson krejt automatikisht. Ajo që fëmija mëson me dëshirë, i mbetet atij më gjatë në kujtesë.

#### *Objektivi gjuhesor:*

Mësimi i gjuhës frënge në klasë të 3-të nuk është thjesht njohje e rregullave fonetike, morfosintaksore, leksikore, por kompetencë komunikimi, që nënkupton mësimin e strukturave të gjuhës në mënyrë automatike pa dashur të gjejë patjetër një arsye logjike. Përvetësimi i gjuhës bëhet në mënyrë të natyrshme sikur mëson gjuhën e nënës.

*Objektivi socialkulturor:*

Nxënësit ballafaqohen me kultura të ndryshme botërore duke vepruar në situata ndërkulturore. Pra gjuha është si një kod që të prin udhën drejt kulturës dhe që ndikon në kulturën e atyre që e flasin. Këta objekta integrohen në një strategji të mësuarit të gjuhës frënge, që i korrespondojnë rekomandimeve të Kuadrit të përgjithshëm evropian për gjuhët.

**3. Përshkrimi i katër aftësive gjuhësore**

Realizimi i komunikimit arrihet nëpërmjet zhvillimit të katër shprehive gjuhësore të harmonizuara në procesin mësimor.

Aftësitë gjuhësore janë:

- **Të dëgjuarit**
- **Të folurit**
- **Të lexuarit**
- **Të shkruarit**

***Të dëgjuarit***

Nxënësi:

- Kupton drejtime të shprehura thjesht, si të shkojë nga një vend në tjetrin, të mbyllë portën, dritaren, çantën, librin, të nxjerrë mjetet shkollore në bankë dhe t'i përdorë ato.
- Kupton kur dikush i flet shumë ngadalë me artikulum të kujdesshëm, me pauza të gjata për ta lejuar atë të asimilojë kuptimin.

***Të folurit***

Nxënësi:

- Pyet dhe u përgjigjet pyetjeve të thjeshta rreth kohës, ditëve të javës.
- Reagon ndaj situatave shumë të njohura në mjedisin ku ai jeton.
- Shqipton drejt fjalë dhe fraza të thjeshta të mësuara më parë.
- Përdor stukturat bazë dhe një fjalor të thjeshtë të përdorimit të përditshëm.
- Përdor mimiken, jep dhe i merr dicka dikujt tjetër nëpërmjet të folurit.

***Të lexuarit***

Nxënësi:

- Përshtat tingullin me simbolin, lexon fjalë konkrete dhe fraza të thjeshta me një fjalor të njohur.
- Kupton informacione që janë të lidhura me njerëzit dhe vendet përkatëse, si: vendbanimi, mosha etj.
- Ndjek udhëzime të thjeshta të shkruara për t'u orientuar në një vend të caktuar, si: "Ec djathtas!", "Kthehu majtas!" etj.
- Kupton mesazhe të shkurtra, të thjeshta, të shkruara në kartolina, si: përshëndetje dhe urime për Krishtlindjet, Vitin e Ri, ditëlindje etj.

***Të shkruarit***

Nxënësi:

- Plotëson një pyetësor me të dhëna vetjake, si: emri, mbiemri, adresa, kombësia.
- Kopjon fjalë dhe fjali të shkurtra që i ka mësuar, bën ushtrime me plotësim vëndesh bosh.
- Krijon fjali me etiketa.

#### 4. Struktura sintetike e programit

35 javë x 2 orë	70 orë
Mësime të reja	48 orë
Përsëritje gjatë vitit	8 orë
Test	4 orë
Këngë, poezi, përralla, lojëra, fabrikim, civilizim	10 orë

#### 5. Struktura analitike e programit

*Mësime të reja (48 orë)*

Mësuesi është i lirë që çdo mësim ta planifikojë vetë sa orë do ta ndërtojë, në varësi me nivelin e klasës ku ai jep mësim.

*Përsëritje gjatë vitit (8 orë)*

Gjatë orëve të përsëritjes mësuesi ka për qëllim të përcaktojë strukturat bazë gramatikore e leksikore të dhëna më parë, duke i vendosur ato në situata autentike dhe të përshtatshme me realitetin.

*Teste (4 orë)*

Testet janë vetëvleresues, nëpërmjet të cilave nxënësi vlereson veten për ato çfarë ka mësuar gjatë semestrit dhe vitit.

*Këngë, poezi, përrallë, lojëra, fabrikim, civilizim (10 orë)*

Në këtë program një vend i rëndësishëm u është kushtuar këngëve, poezive, lojërave etj., mbasi duke luajtur nxënësi përdor gjuhën për të realizuar një qëllim të vërtetë: “Të luaj”. Në këto raste, gjuha kthehet autentike dhe kuptimplotë, pasi vetë loja bëhet e tillë. Ata thithin të gjithë informacionin e ri duke aktivizuar të gjitha shqisat e tyre, përvetësojnë më mirë atë çka shohin, dëgjojnë, flasin dhe, në të njëjtën kohë, bëjnë.

T’u mësosh fëmijëve këngë dhe vjersha, do të thotë të përdorësh me sukses metodologjinë e lojës, metodë kjo bashkëkohore që respekton nevojat afektive dhe psikologjike të fëmijës që mëson një gjuhë të huaj.

#### ❖ Tematika dhe leksiku

- Veprimtari të përditshme:

- familja ime,
- shtëpia ime,
- ngjyrat,
- lojërat,
- pjesët e trupit.

- Jeta shkollore:

- shkolla,
- klasa,

- shokët,
- shoqet.
- Dita ime
- vaktet e ngrënies,
- momentet e ditës.
- Numrat 1 –20.
- Kafshët.

### ❖ Aktet dhe funksionet e komunikimit

- se présenter(je suis...,je me présente...)
- saluer (bonjour, salut, au revoir...)
- parler de ma famille (c'est mon père, ma mère...)
- décrire le temps qu'il fait (beau, mauvais...)
- dire l'heure qu'il est (quelle heure est'il...)
- prendre congé(aurevoir, à bientôt...)
- se situer dans l'espace (à droite, à gauche, ici, là- bas...)
- exprimer des goûts,des préférences (j'aime, je n'aime pas...)
- exprimer l'affirmation (oui,bien sûr...)
- exprimer la négation (non,...)

### ❖ Strukturat gramatikore

Përvetësimi i njohurive gramatikore bëhet duke shfrytëzuar situatat e komunikimit në klasë dhe ndërthuren me zhvillimin e të folurit. Në këtë moshë fëmijët mësojnë struktura gramatikore në mënyrë mekanike, pa dashur të gjejnë patjetër një arsye logjike.

- le présent (affirmative, négative, interrogative)
- les articles définis(le, la, l' , les)
- les articles indéfinis(un,une,des)
- le pluriel des mots
- les adjectifs possessifs (mon ...)
- les prépositions (à, de )
- l'impératif
- les questions: Qui est – ce? Qu'est que c'est? Quand ...? Où?
- les verbes: être, avoir, aller, faire, jouer, regarder, ouvrir, fermer, manger, saluer, prendre, mettre, donner etc...

### *Fonologji*

Fonetika në kl. III-të jepet nëpërmjet veprimtarive ludike. Duke ndjekur një lloj ritmi muzikor gjatë mësimin të këngëve e të poezive, e aftësojnë nxënësin të shqiptojë fjalët e fjalitë me ritmin e shpejtësinë që vetë gjuha e ka. Në këtë mënyrë i afrohem vetë temporit natyror me të cilin recitojnë apo këndojnë fëmijët e asaj moshe.

## 6. Udhëzime didaktike




Psikologjia moshore a mëson sot se një fëmijë i vogël përkushtohet dhe tregon kujdes për diçka që e do. Atë që ai e bën me dëshirë, i mbetet më gjatë në kujtesë. Prandaj mësuesi të tregojë kujdes të madh për të vendosur marrëdhënie të mira me fëmijën që në fillim.

Mësimi i gjuhës frënge nuk është vetëm një proces natyror, or i drejtuar nga mësuesi. Në çdo orë mësimi fëmija ka rastin të flasë dhe në të njëjtën kohë ta shoqërojë të folurit e tij edhe me lëvizje. Edhe gjetet e vogla gjatë recitimit të historive të shkurtra, poezive, veprimeve pohuese e mohuese, tundja e kokës në shenjë pohimi dhe mohimi etj., e bëjnë të folurit më të gjallë dhe më të gëzueshëm për fëmijën. Sa më shumë akte të foluri të shoqëruara me lëvizje të ofrojë mësuesi, aq më lehtë mund të riprodhojnë fëmijët. Një rol të rëndësishëm zënë ato lojëra që kërkojnë punën në grup, mbasi fëmijët ndihen më të kënaqur të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin dhe të jenë të barabartë. Lojëra me lëvizje, përdorime mimike, për të zhvilluar kujtesën, si: gjëgjëza, loja “Telefoni i prishur”, inskenime me kukulla, maska etj., që janë të thjeshta për t’u përgatitur nga mësuesi, janë objekte shumë të rëndësishme për të realizuar qëllimin tonë.

## 7. Metodologjia e vlerësimit dhe vetëvlerësimit

Vlerësimi tek fëmijët e vegjël nuk mund të bëhet vetëm me anë të testit, por edhe duke mbledhur informacion konkret për nivelin e nxënësve, bazuar në ecurinë e tij gjatë orëve të mësimt, duke vënë në dukje anët pozitive dhe duke qortuar mangësitë. Kjo e lejon nxënësin të përmirësojë performancën e tij. Mësuesi bisedon me nxënësin individualisht duke i treguar arritjet. Ai shënon dhe vlerëson përparimin sistematik nëpërmjet vëzhgimeve, pyetjeve, detyrave të shtëpisë e të klasës.

Nxënësi është mirë të vlerësohet jo vetëm me notë, por edhe me komente, si: “Të lumtë goja!”, “Të lumtë dora!”, “Shumë mirë!” etj. Testet të jenë vetëvlerësuese mbasi vetëvlerësimi është një element i rëndësishëm për mësimin e gjuhës frënge në këtë grupmoshe. Nxënësit vlerësojnë vetveten për atë çka është parashikuar në program. Vetëvlerësimi mund të bëhet me anë të një skeme:

Je sais			
Compter 1 à 20			
Dire...			
Saluer...			

## 8. Kriteret për hartimin e tekstit

Në hartimin e tekstit të klasës së tretë të mbahet parasysh se kjo metodë i drejtohet një fëmijë 8-9-vjeçar që mëson për herë të parë një gjuhë të huaj. Fëmija ka nevojë për ngrohtësi, për lirshmëri, të ndihet i motivuar për të mësuar këtë gjuhë. Prandaj metoda duhet t'u përgjigjet kërkesave dhe interesave të kesaj grup-moshe. Nëpërmjet saj fëmija:

- Të zbulojë
- Të veprojë,
- Të bashkëveprojë.

Metoda duhet të jetë:

- Me ngjyra ,
- Me personazhe të dashura për fëmijët,
- Plot me veprimtari ku fëmija të ketë mundësi të degjojë, të shikojë, të flasë, të prekë, të ndjejë gjate bashkeveprimit me shokët në klasë.
- Veprimtaritë të nxisin imagjinatën dhe kreativitetin e fëmijës.
- Rubrika “Qytetërim” të jetë hapje ndaj kulturës frankofone dhe gjuhës franceze.
- Të ketë veprimtari që lidhin familjen me klasën, si,p.sh.: fëmija sjell në klasë lodrën e tij që pëlqen më shumë apo u tregon prindërve një vizatim që ka bërë në klasë etj.
- Të ketë veprimtari që e lejojnë fëmijën të ndjejë ritmin, tingullin dhe intonacionin e gjuhës (kasetë)
- Të ketë ushtrime me shkrim nëpërmjet historive, përrallave të shkurtra, komente të thjeshta për figura, me etiketa.
- Të ketë veprimtari që forcojnë bashkëpunimin dhe shmangin konkurrencën.
- Të ketë veprimtari për të katra aftësitë,
- Teksti të jetë i njësuar në ndërtim dhe me objektiva të qartë.
- Të ketë skema vetëvlerësuese që e lejojnë fëmijën të vetëqortohet.
- Metoda të jetë e shoqëruar me libër mësuesi.

Numri i faqeve 120 A4, me katër ngjyra. Formati 260 x 200 mm.